

UDHËZUES

SI TË SHKARKONI DHE PLOTËSONI DEKLARATAT TATIMORE NGA WEB FAQJA E ATK-SË

Pasi të filloni të plotësoni këtë formë së pari duhet të instalohet në kompjuterët tuaj **Acrobat Reader**, pasi që pa këtë software nuk mundeni të merrni deklaratën nga web faqja.

Vazhdojmë me plotësimin e fushave për shkarkimin e Deklaratës Tatimore.



Ky aplikacion në rrjet është dhënë nga Administrata Tatimore e Kosovës për të lejuar shtypjen direkte të deklaratave me kërkesë.

The screenshot shows a web form with the following fields and options:

- Language selection: [Shqip](#), [Srpski](#), [English](#)
- Numri fiskal: [Vazhdo](#)
- Emri:
- Deklarata Tatimore:
- Periudha Tatimore:
- Teksti me pamje:
- Buttons: [Merrni deklaratën!](#)

Instructions on the left:

- SE PARI ZGJEDHNI **GJUHËN** (Në rastin tonë ne marrim dhe zgjedhim Gjuhën **Shqip**)
- Tek rubrika **Numri Fiskal** shëno Numrin Fiskal (p.sh 60000000).
- Tek rubrika **Deklarata Tatimore** Zgjedhim Llojin e Formularit (p.sh ne zgjedhim: **CD - Tatimi në të Ardhurat e Korporatave**).
- Tek rubrika **Periudha Tatimore** zgjedhim periudhen për të cilën do të deklarojmë me këtë formular (p.sh.2009)
- Brenda një kohe të shkurtër duhet të plotësoni fushën nën foton e paraqitur p.sh **KODVH**, pasi që mandej nuk ju lejon te kaloni ne hapin tjetër (atëherë nëse ndodhë kjo ndalesë atëherë shtypeni butonin Refresh dhe gjithçka rregullohet). Te shënohen numrat dhe Shkronjat ashtu siç edhe shihen nga ana juaj. Nëse teksti është me shkronja të mëdha duhet të shënohen me shkronja të mëdha nëse shënon të kundërtën nuk mundesh te shkarkosh deklaratën.
- Pasi te keni plotësuar te gjitha fushat e kërkuara në këtë formë atëherë mund të shtypni mbi butonin **Merrni Deklaratën**.

Services listed on the right:

- [1. Formulari Regjistrimi Për TVSH](#)
- [2. Formulari Ndryshimesh Për Regjistrimin Në TVSH](#)
- [3. Kërkesë për Cert. Importi dhe Eksporti](#)
- [4. Kërkesë për Refundim Pensional për të vetpunësuarit](#)
- [5. Kërkesë për Refundim Pensional për punëdhënësin](#)
- [6. Formulari Aplikacioni Për Regjistrim Për Korporatat E Vogla Që Vendojnë Të Tashmën Sipas Skemës Së Tatimit Mbi Të Ardhurat Reale](#)
- [7. Formulari Aplikacioni Për Bizneset Individuale Që Vendojnë Të Tashmën Sipas Skemës Së Tatimit Mbi Të Ardhurat Reale](#)

Para hapjes na shfaqet një dritare ky na pyetë a do ta ruajmë apo vetëm do të hapim dokumentin, ne po zgjedhim (vetem me hapë). Mandej Hapet dritarja me deklaratën përkatëse.

Rubrikat qe janë te plotësuar me shkronja të kuqe në rastin tonë plotësohen automatikisht kurse fushat tjera të zbrazëta duhet ti plotësoni ju si tatimpagues.

Duke filluar nga rubrika [6], [8] ... e kështu me radhë.

Më poshtë është forma e formularit 


REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCËVE - MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE - MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE
ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS - PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA - TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO

CD **DEKLARATA E TATIMIT NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE**

[1] Periudha e Deklarimit:

[3] Numri i Regjistrimit të biznesit (8 Shifra):

[4] Emri i tatimpaguesit:

[5] Adresa e tatimpaguesit:

[6] Pronari: Telefoni:

[7] Menaxheri: Telefoni:

[8] Kontabilisti/Mbajtësi i librave: Telefoni:

[9] Nëse deklarata tatimore është për të ndryshuar deklaratën e plotësuar më herët për të njëjten periudhë, vendose 'X' në kutinë që përshkruan llojin e ndryshimit. (Ju lutemi referohuni doracakut)

Shtesë Korigjim Vetëm pagesë

[48] Shuma obligative (Barteni shumën nga kutia [43])

[49] Shuma e tatimit të paguar

Unë deklaroj se faktet e raportuara në këtë deklaratë tatimore janë të vërteta.

Emri/Mbiemri/Nënskrimi dhe Vula


Data:


Pjesa e bankës

Nënskrimi dhe vula	Numri i llogarisë: 1000420070000373	Shuma e tatimit të paguar _____ €
	Teksti:	
	Data: __/__/_____	

[10] Fitimi neto (humbja) sipas pasqyrës Financiare		
Rregullimet në të ardhurat		
[11] Të Ardhurat me Burim të Huaj (Tabela A).....		
[12] Arkëtimi i Borxheve të Këqija (Tabela B).....		
[13] Fitimet Kapitale (Tabela C).....		
[14] Dividentet (Tabela D).....		
[15] Të ardhura/fitime te tjera (Tabela E).....		
[16] Rregullimi total në të ardhura (mblihd kutijat [11] deri[15]).....		
[17] Fitimi (humbja) pas rregullimit në të ardhura (kutia [10] + kutia[16]).....		
Rregullimet në shpenzime		
[18] Shpenzimet e pazbritshme (Tabela F).....		
[19] Shpenzimet e përfaqësimit (Tabela G).....		
[20] Fondet Rezervë (Tabela H).....		
[21] Pagesat për Personat e Lidhur (Tabela I).....		
[22] Amortizimi (Tabela J).....		
[23] Zhvlerësimi (Tabela K).....		
[24] Lejimi special për asetet e reja (Tabela L).....		
[25] Humbja kapitale (Tabela C).....		
[26] Shpenzime te tjera (Tabela M).....		
[27] Rregullimi total në shpenzime (Mblidh kutiat[18] deri[26]).....		
[28] Fitimi (humbja) e biznesit pas rregullimit në shpenzime (kutia [17] - kutia[27]).....		
[29] Kontributet Bëmirëse (bashkangjit deftesat).....		
[30] Humbjet e mbartura (referoju doracakut).....		
[31] Mblidh kutiat[29] dhe[30].....		
[32] Fitimi i axhustuar, (kutia[28]- kutia[31]).....		
[33] Tatimi në të Ardhurat e Korporatave (Nëse kutia [32] është fitim, shumëzo me 20%. Nëse kutia[32] është humbje, vendos 0).....		
Vetëm për Kompanitë e Sigurimeve		
[34] Primet bruto për periudhën tatimore.....		
[35] Tatimi në të Ardhurat e Korporatave për Kompanitë e Sigurimeve ([34] * 7%).....		
Rimbursimi ose Obligimi		
[36] Tatimi në të Ardhurat e Korporatave (mblidh shumën në kutinë[33] me kutinë[35] sipas situatës suaj).....		
[37] Kreditimi tatimor nga shtetet e huaja (Tabela O).....		
[38] Tatimi i mbajtur në Dividente, Interes, të Drejtat Pronësore dhe Qira nga paguesit rezident (Tabela P)- bashkangjit certifikatat).....		
[39] Totali i krediteve për periudhë[37] +[38].....		
[40] Kutia[36] minus[39].....		
[41] Këstet e paguara (Tabela Q).....		
[42] Tatimi për pagesë me këtë formular [40]- [41].....		
Në qoftë se rezultati në kutinë [42] është pozitiv, ju keni një shumë si Obligim . Nëse rezultati në kutinë [42] është negativ, ju keni të drejtë për Rimbursim . Shkruani shumën në kutinë e duhur		
[43] Obligimi		[44] Rimbursimi
[45] Emri i bankës		
[46] Mbajtësi i llogarisë.....		
[47] Numri i llogarisë (sheno 16 shifra)....		

Posa të plotësoni të gjitha fushat e nevojshme në këtë formularë atëherë shtypni File>Print.

Atëherë na shfaqet dritarja tjetër 



Në këtë rubrikë shënoni numrin 3 në vend të numrit 1 pasi që ju duhen 3 kopje të formularit të plotësuar (një kopje e ndal Banka, një kopje Administrata Tatimore dhe kopjen e 3-të e ndalë për nevojat e juaja).

Vërejtje: Nëse keni harruar të ndryshoni numrin nga 1 në 3 atëherë ju lutemi që të fotokopjoni këtë formular.

Fotokopja e formularit duhet të jetë shume e pastër pasi që në Sistemin e ATK-së mandej nuk mund të procesohet (nëse është dobët e fotokopjuar).

Nëse keni ndonjë problem lidhur me shkarkimin e deklaratave tatimore ju lutem të kontaktoni në këtë numër e telefonit **038/200 250 17**